

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 19-25.05.2025

Janë testuar gjithsej 152 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=166) është shënuar një rënie prej 8,4%. Nuk janë regjistruar raste pozitive.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 19-25.05.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
19.5.2025	37	0	0,0%
20.5.2025	21	0	0,0%
21.5.2025	33	0	0,0%
22.5.2025	26	0	0,0%
23.5.2025	16	0	0,0%
24.5.2025	7	0	0,0%
25.5.2025	12	0	0,0%
Gjithsej	152	0	0,0%

Gjatë javës së kaluar (19-25.05.2025) janë regjistruar 2 persona të shëruar. Nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e COVID – 19.

gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 25.05.2025 janë regjistruar gjithsej 45 raste me COVID-19. Në muajin prill të vitit 2025 numri i të sëmurëve (n=9) është për 2 herë më i madh se në muajin mars 2025 (n=4).

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 2 raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

Gjatë vitit 2025, deri më 25.05.2025, janë testuar gjithsej 5.350 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Gjatë periudhës së kaluar po regjistrohet vazhdimisht një përqindje e ulët e rasteve pozitive. Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Variantet që qarkullojnë aktualisht nuk ka gjasa të shoqërohen me ndonjë rritje të ashpërsisë së infeksionit krahasuar me variantet që qarkullonin më parë ose një ulje të efektivitetit të vaksinës kundër sëmundjes së rëndë.

Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i rasteve me COVID-19 në nivel javor është i ulët, duke pasur parasysh se ndodhemi në një periudhë të një qarkullimi të rritur të viruseve respiratore në hemisferën veriore, nevojitet një mbikëqyrje e vazhdueshme (epidemiologjike dhe virusologjike) në rrafsh lokal dhe kombëtar.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 26.05.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>